



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-2862/1 nga 14.06.2023, **NDËRPRITET.**

Sipas pretendimeve të lëndës vepron organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-2862 nga 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2862/1 datë 14.06.2023 është formuar në bazë të denoncimit së paraqitur nga një parashtrues i panjohur. Pretendimet në denoncim i referohen dyshimeve për kryerje joprofesionale dhe të pakujdesshme të funksionit noterial nga një zyrtar ///. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Nuk u paraqit asnjë provë në mbështetje të kërkesës.

Pas mbikëqyrjes së përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi shqyrtimin e pretendimeve në fjalë nga Dhoma e Noterisë së RMV-së dhe Ministria e Drejtësisë e RMV-së, nga të cilat u morën përgjigjet se ishte realizuar kontroll në punën e personit zyrtar të përmendur, për të cilin është bërë procesverbal me shkrim, në të cilin konstatohen situata të caktuara, për të cilat ndërmerren veprime nga organet kompetente sipas pretendimeve në fjalë.

Në kuptim të sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se në lidhje me pretendimet në fjalë është duke vepruar një autoritet tjetër kompetent, për këtë arsye nuk ka bazë që KSHPK-ja të veprojë për rastin në fjalë.

Për sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- arkivi i KSHPK-së

pёrgatiti: Mr. D.D .
miratoi: N.B anёtar i KSHPK-sё.

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

